

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-223/13

Prishtinë,  
9 qershor 2015

Në çështjen juridike të:

**G. D.**

Serbi

**Pala ankuese**

*kundër.*

**M.K.**

Prizren

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët, Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/200/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA137071), të datës 18 prill 2013, pas seancës së mbajtur më 9 qershor 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Pranohet si e bazuar ankesa e G. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/200/2013, i datës 18 prill 2013.
2. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/200/2013 i datës 18 prill 2013, për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA13071.
3. Hedhet si e papranueshme kërkesa e paraqitësit të kërkesës për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA13071 për shkak se kërkesa bie jashtë jurisdikcionit të AKP-ës.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 13 korrik 2006, D. B. (në tekstin e mëtejshëm: Paraqitësi i kërkesës) në cilësinë e anëtarit të ngushtë të familjes dhe në emër të nënës së tij J. B. [(në tekstin e mëtejshëm: Bartësja e së drejtës pronësore (BDP)] ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës dhe dyqanit në sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup>, Rr. Marshal Tita, nr. 16, Prizren, ngastra nr. 3334, Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme (ÇDPP) UL-71813068-05348, e datës 29 dhjetor 2009, Zyra Kadastrale Komunale, Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Përveq kësaj, paraqitësi i kërkesës ka kërkuar edhe kompenzimin e dëmit.  
Ai ka theksuar se posedimin në pronën e kërkuar e kishte humbur me datën 13 qershor 1999, për shkak të rrethanave që kishin ndodhur gjatë konfliktit të armatosur të viteve 1998/99 në Kosovë.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës në mes tjerash ka paraqitur këtë dokumentacion, si vijon:
  - Çertifikata e vdekjes nr. 04-201-1-7, e nxjerrë nga Zyra e Ofiqarisë e Kuvendit të Prizrenit me datë 17 janar 1997. Ky dokument provon faktin e vdekjes së S. B, i cili ka vdekur me 28 Janar 1957;
  - Listen Poseduese nr. 5348, e nxjerrë nga Drejtoria Gjeodete Komunale, Kuvendi i Komunës me datë 17 nëntor 1988. Sipas këtij dokumenti prona e kërkuar është regjistruar në emrin e BDP-ës, i cili ka vdekur me 28 janar 1957;
  - Çertifikata e lindjes e paraqitësit të kërkesës lëshuar nga Komuna e Prizren, Republika e Serbisë, RSFJ me datë 2 dhjetor 1998;

- Leternjoftimi i paraqitësit të kërkesës nr. 702540700181, i lëshuar me datë 13 mars 2000 në Ćukarica, Republika e Serbisë;
- Fletën Poseduese nr. 5348, e nxjerrë nga Drejtoria për Kadastër dhe Pronësi e Komunës së Prizrenit me datë 27 korrik 2005. Sipas këtij dokumenti prona e kërkuar është regjistruar në emër të BDP;
- Padia (C.nr. 685/05) e ushtruar më datë 4 gusht 2005 nga G. D. - motra e paraqitësit të kërkesës (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) në Gjykatën Komunale të Prizrenit. Kjo padi është ushtruar kundër Gj. K. – vëllaut të paraqitësit të kërkesës (në tekstin e mëtejme: Gj. K.) për shkak të pasurimit të pabazë të tij (shfrytëzimit të pronës së kërkuar dhe mospagimit të qirasë nga data 1 korrik 1999 e tutje);
- Padia e ushtruar (C.nr.187/06) me datë 14 shkurt 2006 nga pala ankuese në Gjykatën Komunale të Prizrenit. Kjo padi është ushtruar kundër Gj. K. për lirim të pronës së kërkuar;
- Aktvendimi C.nr. 685/05 i datës 10 mars 2009, i nxjerrë nga Gjykata Komunale në Prizren. Sipas këtij aktvendimi procedura gjyqësore në lëndën gjyqësore C.nr. 685/05 është ndërprerë për shkak të vdekjes së Gj. K.;
- Leternjoftimi i palës ankuese nr. 000678969, i lëshuar me datë 26 maj 2009 nga Republika e Serbisë;
- Aktvendimi i trashëgimisë T.nr. 66/09 i Gjykatës Komunale në Prizren i nxjerrë me 17 qershor 2009. Sipas këtij aktvendimi trashëgimtar në pronën e kërkuar janë shpallur: pala ankuese [G. D. (e vajzërisë B.)] dhe L. G. (e vajzërisë B.) secila në 1/3 e pronës së kërkuar, ndërsa D. V. e D. I. (e vajzërisë V.) secili në 1/6 e pronës së kërkuar – përkatësisht motrat, nipi dhe mbesa e paraqitësit të kërkesës;
- Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71813068-05348 e datës 29 December 2009, e nxjerrë nga Zyra Kadastrale Komunale, Komuna e Prizrenit. Sipas këtij dokumenti prona e kërkuar është rexhistruar në emër të palës ankuese dhe L. G. (e vajzërisë B.), secila në 1/3 e pronës së kërkuar dhe D. V. e D. I. (e vajzërisë V.) secili në 1/6 e pronës së kërkuar – përkatësisht motrat, nipi dhe mbesa e paraqitësit të kërkesës;
- Kërkesa e palës ankuese e datës 8 shkurt 2010 (e dorëzuar në AKP me datë 9 shkurt 2010), me të cilën ajo kërkon nga AKP-ja që kërkesën e paraqitur (KPA13071) nga paraqitësi i kërkesës (vëllau i saj) ta saktësonte si kërkesë të saj, L. G., D. V. dhe D.I.;
- Aktvendimi C.nr. 187/06 i datës 15 shkurt 2010. Sipas këtij aktvendimi Gjykata Komunale e Prizrenit e kishte ndërprerë procedurën gjyqësore në lëndën C.nr. 184/06 për shkak të vdekjes së Gj. K.;

- Kërkesa e palës ankuese të datës 18 korrik 2010 (e dorëzuar në AKP me datë 14 korrik 2010), me të cilën ajo kërkonte pësëri nga AKP-ja që kërkesën e paraqitur (KPA13071) nga paraqitësi i kërkesës (vëllau i saj) të saktësonte si kërkesë të saj, L. G., D. V. dhe D.I., për shkak se me datën 17 qershor 2009 kishte përfunduar procedura e trashëgimisë dhe se prona e kërkuar tanimë ishte pronë e tyre (sipas aktvendimit të sipërcekur të trashëgimisë T.nr. 66/09);
  - Letra e palës ankuese mbi ndërrimin e adreses të datës 27 korrik 2011 (sipas këtij dokumenti adresa e re ishte: Remetinska 19D, Kumodraž, Beograd, Serbi);
  - Propozimi i padatë i palës ankuese për përmbartimin e aktvendimit C.nr. 187/06 të Gjykatës Komunale në Prizren (i dorëzuar në AKP me datë 5 mars 2013);
  - Deklarata e J. (J.) B. e datës 11 prill 2013. Në këtë deklaratë J. B., mohon faktin se ka lidhur kontratën me Gj. K. [(në tekstin e mëtejme: J. (J.) B.)] dhe ka theksuar se ai nuk kishte nënshkruar kurfarë kontrate mbi shitëblerjen me Gjergj Kuzhninin në lidhje me pronën e kërkuar.
3. Nga raportet e verifikimit të AKP-ës të datave: 30 nëntor, 6 e 18 dhjetor 2006, 6 tetor 2008 dhe 13 tetor 2011 shihet se lista poseduese e parë (nr. 5348), fleta poseduese e dytë (nr. 5348), aktvendimi i trashëgimisë T.nr. 66/2009 dhe Çertifikata UL-71813068-05348, janë gjetur dhe si të tilla kanë mundur të verifikohen pozitivisht.
  4. Më 30 dhjetor 2010, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së i ka njoftuar palët e treta potenciale lidhur me kërkesën duke vendosur njoftimin në pronën e kërkuar. Me datën 5 janar 2011, mbi bazën e ortofotos, koordinatave GPS si dhe ekspertit të njoftimit, Sekretaria Ekzekutive e AKP-ës ka konfirmuar se njoftimi i pronës së kërkuar ishte i saktë.
  5. Më 28 shtator 2012, M. K. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në kërkesë) ka paraqitur përgjigjen në kërkesën e paraqitur. Pala përgjegjëse konsideron se pronën e kërkuar dhe dy vëllezërit e tij K. e Gj. K. e kishin blerë në vitin 1991. Për të mbështetur pretendimet e tija, pala përgjegjëse në kërkesë ka paraqitur këto dokumente:
    - Kontrata e pavërtetuar e shitëblerjes së paluajtshmërisë, e datës 20 maj 1991. Sipas kësaj kontrate të pavërtetuar, prona e kërkuar, nga J. (J.) B. i është shitur Gj. K.;
    - Aktvendimi nr. 313-281 i datës 1 qershor 1991. Sipas këtij aktvendimi Gj. K. i është lejuar hapja e dyqanit të pavarur zejtar-arëpunues;
    - Deklarata nr. 5746/2003 e vërtetuar me datë 30 dhjetor 2003. Sipas kësaj deklaratë dëshmitarët: J.B., H. Th. dhe P. S., pretendojnë të dëshmojnë faktin se pronën e kërkuar Gj.K. e kishte blerë nga J.(J.) B. dhe atë me datë 20 maj 1991;
    - Leje e vozitjes nr. 17275 e palës përgjegjëse në kërkesë e lëshuar me datë 13 dhjetor 1995.

- Deklarata në dorëshkrim e Gj. K. e datës 21 August 2003. Në këtë deklaratë ai thekson se pronën e kërkuar e kishte blerë me 20 maj 1991 nga J. (J.) B.;
  - Deklarata no. 5747/2003 e vërtetuar me datë 30 dhjetor 2003. Sipas kësaj deklaratë Gj.K. e kishte blerë nga J. (J.) B. në vitin 1991 në praninë e tre dëshmitarëve dhe se prej vitit 1991 nuk ka pasur kurrfarë problemi nga pronari i mëparshëm;
  - Letërnjoftimi i avokatit O. R. nr. 1003102064 i lëshuar me datë 13 mars 2009 nga ana e Ministrisë së Mbrendshme e Republikës së Kosovës;
  - Parashtrësia e datës 1 gusht 2012 e paraqitur nga pala përgjegjëse në kërkesë. Sipas kësaj shkresë ai shpjegon se pronën e kërkuar e kishte blerë nga paraqitësi i kërkesës;
  - Autorizimi i datës 21 shtator 2012. Sipas këtij dokumenti pala përgjegjëse ka autorizuar avokatin O. R. që të përfaqësojë pranë Agjencionit Kosovar të Pronës;
6. Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore i Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPB) në vendimin e tij HPCC/D/217/2005/C të datës 20 gusht 2005, për të njejtën pronë (pronën e kërkuar) ka refuzuar kërkesën e kategorisë C të paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës [(i person njejtë edhe para AKP/KKPK (D. B.) është paraqitësi i kërkesës)] për sa i takon të drejtës së posedimit, me arsyetimin që Paraqitësi i kërkesës nuk kishte paraqitur ndonjë dokument të vërtetuar si provë për të dëshmuar se ai kishte posedimin në pronën e kërkuar.
7. Me vendimin KPCC/D/C/200/2013 të datës 18 prill 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) ka refuzuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës. Arsyetimi i vendimit të KKPK-së, në pikën 44 të tij, nënvizon: *“[Paraqitësi i kërkesës e mohon faktin që prona e kërkuar të jetë shitur ndonjëherë, megjithatë, ai pranoi se familja e tij nuk ka qenë në posedim të pronës së kërkuar, që në vitin 1972...].”* I njejtë vendim në pikën arsyetuese 45 të tij, e kundërshton aktvendimin e trashëgimisë (T.nr. 66/09, të datës 17 qershor 2009), sipas së cilit motrat, nipi dhe mbesa e paraqitësit të kërkesës janë shpallur trashëgimtar në pronën e kërkuar. Kjo sepse: *“[...vendimi i trashëgimisë mund të jetë shqyrtuar gabimisht pasi ai shpërfill ekzistencën e kontratës së blerjes të lidhur mes të familjes së paraqitësit të kërkesës dhe familjes së palës përgjegjëse, sipas së cilës familja e palës përgjegjëse ka përfituar pronësinë e kërkuar”*. Për më tepër vendimi i Komisionit kontratën jo formale të shitëblerjes së pronës së kërkuar (të datës 20 maj 1991), të pavërtetuar në gjykatë, e konsideron si të vlefshme, meqë në kohën e lidhjes së saj, i aplikueshëm ishte ligji diskriminues, i cili i pamundësonte palëve (te etniteteve të ndryshme) vërtetimin e kontratave. Më tutje, Komisioni në vendimin e tij thekson: *“Kontrata e blerjes krijon një supozim të pronësisë në favor të palës përgjegjëse”,* dhe se: *“Parashtrësia e pambështetur e paraqitësit të kërkesës për të kundërshtuar ekzistencën e kontratës së blerjes është e pamjaftueshme për të kundërshtuar këtë supozim”*. Përfundimisht, Komisioni në arsyetimin e vendimit të tij konstaton

se: “[...paraqitësi i kërkesës ka dështuar të vërtetojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet]”.

8. Vendimi i KKPK-ës KPCC/D/C/200/2013, i datës 18 prill 2013, i është dorëzuar O.R., avokatit të palës përgjegjëse në kërkesë (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë) me datë 22 korrik 2013. Me 23 korrik 2013, i njejtë vendim (pas bisedës telefonike që AKP-ja kishte me paraqitësin e kërkesës) i është dorëzuar T. D. - kushëririt të paraqitësit të kërkesës.
9. Me datën 30 korrik 2013, pala ankuese, si njëra nga bashkëpronarët e pretenduar në pronën e kërkuar, ka ushtruar ankesën kundër vendimit të sipërcekur të KKPK-ës. Me datën 31 tetor 2013, pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar një version të përkthyer të ankesës së ushtruar, por që nga shkresat e lëndës rezulton se ai nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

**Pretendimet e palëve:**

*Paraqitësi i kërkesës:*

10. Paraqitësi i kërkesës në procedurën para AKP/KKPK-ës pretendon se pronar i pronës së kërkuar ishte BDP-ja, dhe se e njejtë pronë ishte uzurpuar nga Gj. K.. Ai ka theksuar se pas kërkesës së paraqitur qëndrojnë edhe persona të tjerë të interesuar dhe që janë trashëgimtar të BDP-ës. Më pas ai ka deklaruar se kërkesën e paraqitur e ka bërë në emër dhe për dy motrat dhe fëmijët e motres së ndjerë të tij, meqënëse sipas tij pronën e kërkuar e kanë trashëguar ata, dhe se ai nuk kërkontë asgjë në të.

*Pala ankuese:*

11. Pala ankuese me ankesën e saj të ushtruar ka kundërshtuar vendimin e KKPK-ës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit material.
12. Pala ankuese pretendon se pronën e trashëguar (së bashku edhe me trashëgimtarët e tjerë) e kanë trashëguar nga BDP-ja dhe se ai ishte dhënë në qira nga J. (J.) B. (djali i axhes së palës ankuese) deri në vitin 1999, ndërsa që i njejtë është uzurpuar nga familja e palës përgjegjëse në ankesë.
13. Pala ankuese pretendon se kontrata e blerjes së pronës së kërkuar nuk është lidhur midis “paraqitësve të kërkesës dhe familjes së palëve përgjegjëse”, ashtu siç theksohet në vendimin e KKPK-ës, por është kontratë e nënshkruar nga Gj. K. dhe J. (J.) B. Sipas saj familja nuk është person juridik dhe se konstatimi në vendimin e Komisionit se kontrata është

- nënshkruar nga familja është i pakuptimtë. Për shkak të kësaj pala ankuese konsideron se vendimi është marrë në pakujdesi.
14. Pala ankuese konsideron se kontrata e pretenduar e blerjes e paraqitur nga ana e palës përgjegjëse në ankesë është false. Më tutje thekson se J. (J.) B. nuk ishte as edhe trashëgimtar i BDP-së, prandaj edhe mbi bazën e kësaj ai edhe nuk ka mundur asnjëherë të disponoj me pronën e kërkuar.
  15. Pala ankuese pretendon se “ata” në procedurën para KKPK-ës kishin propozuar caktimin e një seancë në të cilën J. (J.) B. do të ndëgjohej, meqë pretendohet se ai e ka nënshkruar kontratën. Megjithatë, sipas saj AKP-ja nuk e kishte pranuar këtë si një mënyrë që do të hiqte dilemat nëse kontrata ishte e falsifikuar ose jo. J. (J.) B., sipas ankuses nuk kishte nënshkruar kurrë një kontratë të tillë gjë që sipas saj mund të shihet edhe nga deklarata e tij e vërtetuar (e datës 11 prill 2013) dhe e bashkangjitur ankesës. Më tutje pala ankuese thekson së nëse deklarata dhe ndëgjimi i tij [(J.) B.] nuk do të ishte i mjaftueshem, pala ankuese propozon thirrjen e nje eksperti grafologjik për nënshkrimet dhe dorëshkrimet, i cili do të përcaktonte nëse kontrata e hartuar ishte nënshkruar nga J. (J.) B.. Edhe emri i tij është shënuar gabimisht në vend të “J.” është shënuar “J.”
  16. Për më tepër pala ankuese deklaron se pretendimi se prona e kërkuar është shitur nga J. (J.) B. ose paraqitësi i kërkesës nuk qëndron për faktin se asnjëri nga këta nuk ishte pronar i pronës së kërkuar. Sipas ankuses pronare e pronës së kërkuar nuk është nëna e J. (J.) B. por teza e tij, BDP-ja, dhe se autorizimi i është dhënë atij nga nëna e tij, dhe jo BDP-ja. Kjo për më shumë sepse BDP-ja kishte vdekur gjashtë vjet më herët para se kontrata e pretenduar të ishte lidhur, dhe se edhe nëse do të ekzistonte autorizimi i tillë ai nuk do të ishte valid pas vdekjes së dhënësës së tij.
  17. Pala ankuese deklaron se ekzistimi i ligjeve diskriminuese nuk arsyeton njohjen e kontratës së pavlefshme, meqë pala përgjegjëse në ankesë nuk do të mund të fitonte të drejtën pronësore mbi bazën e blerjes së pronës së kërkuar nga ana e jopronarëve dhe mbi bazën e kontratës së falsifikuar.
  18. Përfundimisht, pala ankuese i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës të pranoj ankesën e saj dhe që të nxjerrë vendimin sipas së cilit do të vërtetonte të drejtat e saja pronësore dhe posedimin në pronën e kërkuar.

*Pala përgjegjëse në ankesë:*

19. Pala përgjegjëse para KKPK-ës në ankesë thekson se ai dhe dy vëllezërit e tij (Gj. dhe K.K.) në mënyrë legjitime e kishin blerë pronën e kërkuar më 20 maj 1991 nga J. (J.) B, i cili ishte

paraqitur si pronar i kësaj prone, dhe se i kishin paguar atij shumën prej 110.000DM. Për më tepër ai thekson se kjo kontrate ishte lidhur në praninë edhe të tre (3) dëshmitarëve të tjerë (H. Th., J. B. dhe P. S.) dhe “në emër të blerësit Gj. K”. Pala përgjegjëse thekson se prona e kërkuar pas vdekjes së dy vëllezërve (Gj. dhe K.K.) shfrytëzohet nga ai. Për të mbështetur këto pretendime pala përgjegjëse në ankesë para AKP/KKPK-ës ka paraqitur kontratën e pavërtetuar të blerjes, si dhe deklaratat e dëshmitarëve që pretendohet se ishin të pranishëm në lidhjen e kontratës së pretenduar si dhe vet deklaratën e Gj. K. tanimë të ndjerë. Pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar edhe se pronën e kërkuar ”e shfrytëzojnë që nga viti 1991”, atëherë kur ka ndodhur edhe shitëblerja e pretenduar.

**Arsyetimi ligjor:**

**Pranueshmëria e ankesës:**

20. Ankesa është e pranueshme. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lifhur më Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komercilae e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L Nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme: Ligji 03/L-079).

**Jurisdikcioni:**

21. Sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të KKPK-ës për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
22. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të palëve para AKP/KKPK dhe pretendimeve në ankesë, dhe pas analizimit të vendimit të ankimuar, Gjykata Supreme konkludon që KKPK-ja gabimisht ka vepruar dhe se nuk ka pasur jurisdikcion që të refuzoj kërkesën e paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës. Prandaj, Gjykata Supreme konkludon se vendimi i ankimuar i KKPK-ës duhet të anulohet dhe kërkesa e paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës duhet të refuzohet si e papranueshme. KKPK-ja nuk ka jurisdikcion te vendos në kërkesën për shkak se Ankuesi dhe paraardhësit e tij nuk kishin humbur posedimin për shkak të rrethanave të lidhura me konfliktin, por për shkak të rrethanave nga koha e parakonfliktit.



23. Konstatimin dhe konkludimin e saj Gjykata e bazon fillimisht në deklarinimin palës ankuese, e cila në komunikimin që ajo kishte patur me AKP-në me datë 7 mars 2013, kishte deklaruar se: *“që nga viti 1972 ne nuk kishim jetuar në pronë”*. Të njëjtën gjë përfaqëson edhe aktvendimi nr. 313-281, i datës 1 qershor 1991, sipas së cilit Gj.K. në pronën e kërkuar i ishte lejuar themelimi i dyqanit të pavarur zejtar-arëpunues.
24. Se humbja e posedimit të pronës nuk është rezultat i rrethanave që lidhen me rrethanat e luftës 1998/1999, flet edhe vendimi paraprak i Komisionit për Çështje Pronësore Banesore (KÇPB) HPCC/D/217/2005/C i datës 20 gusht 2005, për të njëjtën pronë. Kërkesa e kategorisë C e paraqitësit të kërkesës (edhe para AKP/KKPK-ës i njëjti person është paraqitës kërkesë) në lidhje me të drejtën e posedimit është refuzuar, me arsyetimin se ai paraqitësi i kërkesës nuk kishte prezantuar ndonjë dokument të vërtetuar si provë për të dëshmuar se kishte pasur posedim mbi pronën e kërkuar gjatë konfliktit.
25. Gjykata Supreme mund të lë anash nëse Paraqitësi i kërkesës dhe Ankuesi kanë paraqitur mjaftueshem prova për pretendimet e tyre se janë ende pronar të pronës së kërkuar, meqë KKPK-ja nuk ka jurisdikcion, prandaj edhe se nuk mund të vendosi për meritat e kërkesës në këtë rast.
26. Nga arsyet e paraqitura si më lartë dhe sipas nenit 12.2 të Ligjit Nr. 03/L-079 dhe nenit 198 paragrafi 1 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it**

**Rolandus Bruin, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**